



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nënparagrafi d), nenit 40.2 nën c) të Ligjit për Vetqeverisje locale nr.03/L-040, Ligjit Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 30 paragrafi 30.2 me nr.03/L-048 si dhe nenit 15 të Ligjit nr.06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 si dhe nenit 40 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Financave, Ekonomi dhe Zhvillim të dt.05.09.2019 me 01nr.06-38330/2019, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII të rregullt për vitin 2019, të mbajtur me 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Për

Transfer të mjeteve në programin e Arsimit në kategorinë Paga dhe Meditje

I. Miratohët transferi i mjeteve në paga dhe meditje në programin e Arsimit Fillor në vlerë të përgjithëshme prej **19.000.00€**.

II. Transferi behet në sa vijon:

Nga Zyra e Kryetarit vlera prej	2.500,00
Nga Administrata vlera prej	3.300,00
Nga Inspektimet vlera prej	3.500,00
Nga Zjarrëfikësit dhe inspektimet vlera prej	700,00
Nga Zyra e komuniteteve vlera prej	4.000,00
Nga Kadastra dhe gjeodezia vlera prej	1.200,00
Nga Shërbimet kulturore vlera prej	<u>3.800,00</u>
Gjithsejt vlera prej	19.000,00

III. Vendimi si me lartë ka të bëjë me mbulimin e kostos së pagave jubilarë dhe pagave pas pensionimit për punëtorët e arsimit që pensionohen gjatë vitit 2019.

Të gjitha këto vlera që kerkohët të transferohen sipas analizave të shpenzimeve në kategorinë e Pagave për gjashtëmujorin e parë në programet e mesiperme të vitit 2019 janë mjete tepërisht kështu që në gjashtëmujorin e dytë të vitit do të këtë mjete të mjaftueshme për Paga dhe Meditje në këto programe komunale.

- IV.** Vendimi është i plotfuqishem me miratim në Kuvendin e Komunës dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të Ministries së Administrimit të Pushtetit Lokal, kjo në kuptim të nenit 16 dhe 17 të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2017 për Procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës dhe nenit 81 të LVL.

Më vendim njoftohen: MAPL, MF-Departamenti i buxheteve Komunale dhe Thesarit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit të KK të Klinës, Drejtoria e Arsimit, Sherbimi për punë të Kuvendit dhe arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-419091 2019
Klinë, me 04.10 2019

Kryesuesi,
Fadil Gashi

